



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

RrGK lanson Dokumentin e Politikave: Progresi i Kosovës në përafrimin e ligjeve të saja me ligjet e BE-së mbi barazinë gjinore

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) do të prezantojë publikisht dokumentin më të ri të politikave **më 8 nëntor 2017 në Hotel Sirius**, të titulluar Progresi i Kosovës në përafrimin e ligjeve të saja me ligjet e Bashkimit Evropian (BE) mbi barazinë gjinore. Dokumenti është shkruar nga dy avokate të njohura evropiane, të specializuara në çështjet për barazi gjinore, Sylvia Cleff le Divallec dhe Katharina Miller, me kërkesë të RrGK-së dhe mbështetje financiare nga Fondacioni Kvinna till Kvinna.

Në kontekstin e disa reformave të rëndësishme politike në Kosovë (p.sh. në lidhje me Ligjin e Punës, etj.), dokumenti vlerëson shkallën në të cilën ligjet e Kosovës janë përafruar me *Acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Ekspertët identifikojnë mangësitë dhe japin rekomandime për harmonizimin më të mirë të legjislacionit kosovar.

Pas fjalës hyrëse dhe një prezantimi të shkurtër të gjetjeve dhe rekomandimeve kyçe, ky prezantim publik kërkon të krijojë një hapësirë për akterët kyç, për të diskutuar rekomandimet e ekspertëve dhe zbatueshmërinë e tyre në mes të reformave të vazhdueshme të ligjeve dhe politikave publike në Kosovë.

Ky publikim u mundësua me përkrahjen bujare të Fondacionit Kvinna till Kvinna, me përkrahje financiare prej Qeverisë Suedeze.

Mediat janë të mirëseardhura për të marrë pjesë.

Për më shumë informata ju lutem gjeni të bashkangjitur agjendën.